

Vetingu, një shkarkim e dy konfirmime në një javë



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë 3 vendime gjatë jave ndër të cilët 2 konfirmime dhe 1 shkarkim.

Të hënën (me 12 tetor) u shkarkua nga detyra gjyqtarja e Apelit të Korçës Etleva Temo. Gjatë hetimit administrativ, KPK gjeti probleme me deklarin e pasurisë dhe profesionalizmin e gjyqtares.

Të mërkurën (më 14 tetor) u konfirmua në detyrë Prokurorja Pranvera Pustina. Pustina është shefja e kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm Olsian Çela. Vetingu për të u bë në të treja kriteret: të pasurisë, profesionalizmit dhe pastërtisë së figurës. Në asnjërën prej kriterëve, KPK nuk gjeti probleme.

Të premten (me 16 tetor) Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi në detyrë gjyqtaren e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Flora Hajredinaj. Hajredinaj është një prej tre gjyqtareve të trupës së gjykoj çështjen e ish-ministrit Saimir Tahiri. Hajredinaj u konfirmua në detyrë megjithëse gjatë hetimit administrativ, KPK gjeti probleme me justifikimin e pasurisë në të paktën dy raste.